UDHËZIM
Nr. 24, datë 21.10.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 19.2.2018, "PËR PËRCAKTIMIN E ELEMENTEVE PËRBËRËSE TË RAPORTIMIT VJETOR DHE AFATIT PËR RAPORTIM TË INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË"

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 5, datë 19.2.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", fjalia e parë e pikës 3 ndryshon si më poshtë:

"Raporti vjetor dërgohet nga IAL-ja, zyrtarisht, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në 1 (një) kopje origjinale, në formë të shkruar dhe/ose elektronike, brenda muajit dhjetor të çdo viti."

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini